

Gzim Rushiti, MA<sup>1</sup>

UDC: 347.96/.99:347(4-672EY)  
341.45(4-672EY)

**PUNËT E BRENDSHME DHE DREJTËSIA NË BASHKIMIN  
EVROPIAN**

**ВНАТРЕШНИ РАБОТИ И ПРАВДА ВО ЕВРОПСКАТА УНИЈА**

**HOME AFFAIRS AND JUSTICE IN THE EUROPEAN UNION**

**Abstract**

In the European Area of Justice, individuals and businesses should be free to fully exercise their rights. The main purpose of the Judicial Cooperation in Civil Matters is to improve the cooperation between the Authorities of the Member States, in order to remove all obstacles arising from inconsistencies between different judicial and administrative systems. Until the entry into force of the Treaty of Amsterdam, Judicial Cooperation in Civil Matters was carried out through conventions. The Treaty of Amsterdam made Judicial Cooperation in Civil Matters part of Community legislation, including it in the Area of Freedom, Security and Justice. However, the common internal and security policy as an area of cooperation was taken over by the Community gradually over a period of five years. Within the Area of Freedom, Security and Justice, the purpose of Police and Judicial Cooperation in Criminal Matters is to ensure a high level of security for the citizens of the European Union, promoting and strengthening the rapid and effective cooperation between police and judicial authorities. The main purpose of this cooperation is to prevent and fight racism and xenophobia, as well as organized crime, and in particular terrorism, human trafficking, crimes against children, drug trafficking, arms trafficking, corruption and fraud. Police and Judicial Cooperation in Criminal Matters takes place in the following forms: cooperation between national police forces, cooperation between national customs services, cooperation between national judicial authorities.

---

<sup>1</sup> Autori është student në studimet e Ciklit të tretë në Fakultetin Juridik në Manastir në Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit", drejtimi: E drejta ndërkombëtare dhe politika ndërkombëtare, e-mail: ge-zim1990@hotmail.com

**Keywords:** *Home affairs and justice in the European Union, The area of freedom, security and justice in the European Union, Institutions and agencies of the European Union that implement internal and justice policies, The instruments for the implementation of internal and justice policy in the EU*

### **Drejtësia dhe punët e brendshme në Bashkimin Evropian**

Lëvizja e lirë e qytetarëve të BE-së dhe heqja e kontroleve kufitare, përveç përparësive, ka krijuar edhe problem dhe ka ndikuar në rritjen e kriminalitetit ndërkufitar. Me qëllim të intensifikimit të luftës kundër krimit ndërkufitar, BE-ja ka avancuar gradualisht drejt një zone të vetme të drejtësisë dhe në këtë drejtim ka krijuar kornizën e vetë legjislativë krahas asaj të shteteve anëtare. Iniciativat e BE-së në këtë fushë, kanë për qëllim lehtësimin e procedurave të bashkëpunimit të autoriteteve të drejtësisë, në drejtim të rritjes së efikasitetit në luftën kundër kriminalitetit. Kjo është arritur përmes bashkëpunimit policor dhe gjyqësor për çështjet penale, për të siguruar një nivel të lartë sigurie për qytetarët e BE-së. Ky bashkëpunim ka për qëllim luftën kundër krimit të organizuar dhe në veçanti terrorizmit, luftën kundër të gjitha llojeve të trafiqeve dhe krimit kundër fëmijëve, korrupsionit dhe kontrabandës. Në suaza të këtij bashkëpunimi nuk kanë munguar edhe iniciativat për ngritjen e strukturave të posaçme në nivel evropianë për të lehtësuar këtë proces. Përpjekjet për të forcuar bashkëpunimin midis autoriteteve gjyqësore dhe policore në nivel evropian, kanë filluar që me krijimin e vetë BE-së.<sup>2</sup> Bashkëpunimi mes vendeve anëtare në çështjet e drejtësisë dhe në punët e brendshme dhe një seri aktivitete të lidhura me sigurinë e brendshme filloi në mesin e viteve 1970-të si kundërpërgjigje të valës së terrorizmit në Evropën Perëndimore.<sup>3</sup> Përpjekjet e para serioze në drejtim të vendosjes së formave fillestare, mjaft rudimentare të bashkëpunimit ndërqeveritar, kryesisht në sferën e punëve të brendshme, u bënë në seancën e samitit të atëherëshëm, të mbajtur më 1-2.12.1975 në Romë. Bëhet fjalë për marrjen e vendimit politik për fillimin e bashkëpunimeve brenda serisë së grupeve joformale ad hoc. Vendimi për grupin e parë të tillë u mor nga ministrat e punëve të brendshme të shteteve anëtare në 1986. Ndërsa në një seancë të KE të mbajtur më 2-3.12.1988 në Rodos, u mor vendimi për zyrtarizimin e bashkëpunimeve ndërshtetërore më parë joformale që funksiononin brenda grupeve TREVI. Ata ishin bartësit e formave të para joformale të shkëmbimit të informacionit dhe zhvillimeve të përbashkëta policore. strategjitë ndërmjet anëtarëve të

<sup>2</sup> Abdulla Azizi, *Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 315.

<sup>3</sup> Desmond Dinan, *Politikat e Bashkimit Evropian*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, f. 274

qeverive, oficerëve të policisë dhe ekspertëve në fushën e sigurisë së brendshme të shteteve anëtare të Komunitetit Evropian, me qëllim të shtypjes së të gjitha llojeve të terrorizmit dhe të gjitha akteve të mundshme terroriste.<sup>4</sup>

Traktati i Mastrihtit, pos që ndryshoi shtyllën e parë kryesisht ekonomike të ish-BEE-së, inauguroi edhe shtyllën e tretë, që kryesisht ka të bëjë me punët e brendshme dhe drejtësinë për BE-në. Ideja e autorëve të Traktatit të Mastrihtit ishte, pra, që të krijohej një kohezion më i madh brenda BE-së dhe një unitet më i lartë në BE edhe në fushën e policisë dhe të gjyqësisë. Kjo shtyllë prandaj planifikohet të ngrihet në një politikë të përbashkët gjyqësore, policore, të azilit, brenda së cilës do të krijohej një bashkëpunim midis gjykatave, policive, prokurorive dhe hetuesive nacionale të vendeve anëtare në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të njerëzve, larjes së parave, korrupsionit. Meqenëse një nga idetë nismëtare për inaugurimin e shtyllës së tretë ishte dhe mbetet krijimi i hapësirës së sigurt evropiane, BE-ja që nga inaugurimi i kësaj shtylle vazhdimisht u përpoq ta luftojë krimin e organizuar dhe terrorizmin.<sup>5</sup>

Drejhtësia dhe punët e brendshme është korpusi i politikave të Unionit Evropian nga shtylla e tretë, e cila deri në hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës përfshinte: politikat gjyqësore, policore, ato për të drejtat e njeriut, politikat e emigrimit dhe të azilit, e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar dhe policor dhe të ndihmës juridike ndërkombëtare dhe udhëhiqej nga një komisar.<sup>6</sup>

Ekzistojnë nëntë zona që konsiderohen si çështje me interes të përbashkët për bashkëpunim në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme të organizuara me titullin VI të Traktatit.

Ata janë të përcaktuara në nenin K 1, i cili thotë se ata synojnë në veçanti për arritjen e qëllimit i cili është lëvizja e lirë e personave:

- 1) Politika e azilit;
- 2) Rregullat që e rregullojnë kalimin e kufijve të jashtëm të Shteteve Anëtare nga personat dhe ushtrimi i kontrollit të këtij kalimi;
- 3) Politika e imigracionit dhe politika lidhur me shtetasit e vendeve të treta;
- 4) Lufta kundër drogës;
- 5) Lufta kundër mashtrimit me dimension ndërkombëtar;
- 6) Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile;
- 7) Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale;
- 8) Bashkëpunimi doganor;
- 9) Bashkëpunimi për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, trafikimit të drogës dhe formave të tjera të kriminalitetit ndërkombëtarë, për-

<sup>4</sup> Tatjana Petrushevska, Vasko Naumovski, Milena Apostolovska-Stepanoska, Integrimet evropiane, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Fakulteti Juridik "Justiniani i Parë", Shkup, f. 296.

<sup>5</sup> Blerim Reka, Arta Ibrahim, Studime Evropiane, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, f. 71.

<sup>6</sup> Blerim Reka, Otmarr Höll, Ylber Sela, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 126.

fshi këtu nëse është e nevojshme, disa aspekte të bashkëpunimit doganor, bashkëpunim me organizatën në nivel të Bashkimit të një sistemi për shkëmbim të informative brenda një Zyre të Policisë Evropiane (Evropol).

Siç shihet, është fjala për tema klasike që më parë quhej Evropa gjyqësore, të cilave u shtohen çështjet në lidhje me imigracionin.<sup>7</sup> Bashkimi përbën një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie, lidhur me respektimin e të drejtave themelore, sistemeve dhe traditave të ndryshme juridike të Shteteve Anëtare. Ai garanton heqjen e kontroleve të kufijve të brendshëm për personat dhe përcakton një politikë të përbashkët për azilin, imigracionin dhe kontrollin e kufijve të jashtëm, mbështetur në solidaritetin midis Shteteve Anëtare, që të jetë e drejtë kundrejt shtetasve të vendeve të treta. Në kuptimin e këtij Titulli, personat pa shtetësi trajtohen si shtetas të vendeve të treta. Bashkimi bën përpjekje për të siguruar një nivel të lart sigurie përmes masave për parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit, racizmit dhe ksenofobisë dhe përmes masave për bashkërendimin dhe bashkëpunimin midis autoriteteve policore dhe gjyqësore dhe autoriteteve të tjera kompetente, si edhe përmes njohjes së ndërsjellë të aktgjyqësive në çështjet penale dhe, nëse është nevoja, përmes përafrimit të legjislacionit penal. Bashkimi mundëson ushtrimin e të drejtës për t'u drejtuar sistemit të drejtësisë, sidomos përmes parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile.<sup>8</sup>

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe policore të shteteve anëtare synon t'u ofrojë shtetasve të Bashkimit Evropian liri, siguri dhe drejtësi, duke parandaluar dhe luftuar bashkërisht krimin, racizmin dhe ksenofobinë. Bashkëpunimi gjyqësor trajton gjithashtu lehtësimin dhe përsheptimin e bashkëpunimit në fushën e zbatimit të vendimeve penale, lehtësimin e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare, vendosjen e normave penale uniforme në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikut të drogës.<sup>9</sup>

### **Institucionet për realizimin e politikës së Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme**

Politika e përbashkët e drejtësisë dhe e punëve të brendshme realizohet duke përfshirë institucione të BE-së dhe agjenci të ndryshme të cilat drejtojnë, menaxhojnë dhe zbatojnë politikat e parashikuara në lidhje me politikat e 'zonës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë'.<sup>10</sup>

<sup>7</sup> Jacques Pertek, E drejta e institucioneve të Bashkimit Evropian, Dispozita ligjore - Edicioni i I-rë qershor 2004, Botimi i 2-të i rishikuar dhe i zgjeruar : nëntor 2006, Shtypi Universitar i Francës 2004, rruga Reille 6, 75014, Paris, f. 64.

<sup>8</sup> Version i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian, Botuar nga Ministria e Integritimit, Tiranë, Shqipëri, neni, 67.

<sup>9</sup> 15 pyetje për Bashkimin Evropian, Ministria e Integritimit Tiranë, 2007, f. 16.

<sup>10</sup> Abdulla Azizi, Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 315.

Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale zhvillohet në këto forma:

- Bashkëpunimi mes forcave policore kombëtare;
- Bashkëpunimi mes shërbimeve doganore kombëtare;
- Bashkëpunimi mes autoriteteve gjyqësore kombëtare.<sup>11</sup>

Drejtesia dhe Çështjet e Brendshme në Bashkimin Evropian apo politikat e zonës së Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë, përfshijnë një kuadër të gjerë institucional - institucione të BE dhe agjenci të ndryshme - të cilat drejtojnë, menaxhojnë dhe zbatojnë politikat e parashikuara në lidhje me këtë problematikë.<sup>12</sup>

### **Këshilli Evropian**

Këshilli Evropian mbledh së bashku kryetarët e shteteve ose qeverive të shteteve anëtare të BE-së si dhe Presidentin e Komisionit Evropian, në çdo gjatësi muaj. Kjo strukturë e nivelit të lartë politik përcakton prioritetet, drejtimin dhe parimet udhëheqëse politike të BE-së.<sup>13</sup> Këshilli Evropian jep orientimet strategjike për planifikimin legjislativ dhe operacional në zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.<sup>14</sup>

### **Këshilli i Ministrave të BE-së**

Ministrat e DPB-së veprojnë brenda Këshillit që merret me çështjet e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Ky Këshill merr pozicione të përbashkëta, vendime kornizë si dhe harton konventa, duke u bazuar në udhëzimet e Këshillit Evropian. Me përjashtim të disa rasteve, Këshilli vepron me unanimitet. Për sa i përket atyre çështjeve të politikës së DPB-së nën shtyllën e parë (komunitare) është Komisioni Evropian ai që ka të drejtën e propozimit, dhe si rrjedhojë Këshilli i Ministrave mund të marrë vendime vetëm me iniciativë të Komisionit. Rendi i ditës i Këshillit përgatitet nga Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm (COREPER).

---

<sup>11</sup> Fjalorth për Integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian, Ministria e Integritit, Republika e Shqipërisë, Tiranë, Prill, 2010, f. 25.

<sup>12</sup> Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme në Bashkimin Evropian, Buletin, Ky botim realizohet me mbështetjen financiare të Fondit Think Tank, Program i Rrjetit të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur, Budapest, Hungari, Nr. 1, 2018, f. 7.

<sup>13</sup> Abdulla Azizi, Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat, Arbëria Design, Tetovë, 2014, f. 315

<sup>14</sup> Version i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian, Botuar nga Ministria e Integritit, Tiranë, Shqipëri Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme në Bashkimin Evropian, Buletin, Ky botim realizohet me mbështetjen financiare të Fondit Think Tank, Program i Rrjetit të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur, Budapest, Hungari, Nr. 1, 2018, neni, 68

Gjithashtu, ky organ shërben edhe si një forum filtrimi ku çështjet të ndryshme marrin zgjidhjen përkatese (pjesa A e Agjendës së punës së Këshillit) ndërsa për ato aspekte që përfaqësuesit e shteteve anëtare në këtë organ nuk gjejnë konsensus i kalohen Këshillit për diskutim (pjesa B e Agjendës).<sup>15</sup>

### **Komisioni Evropian**

Komisioni Evropian ka të drejtën e iniciativës në fushën e Drejtësisë dhe Çështjet e Brendshme, por këtë të drejtë nuk e ka i vetëm (ai e ndan këtë rol me vendet anëtare). Gjithashtu, Komisioni monitoron zbatimin e legjislacionit të miratuar nga Këshilli/Politika e Drejtësisë dhe Çështjet e Brendshme përbën fokusin kryesor të punës së një prej 36 Drejtorive të Përgjithshme (DG - Directorate General) të Komisionit Evropian. Me rreth 320 punonjës DG e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme është e strukturuar në katër drejtori kryesore sipas problematikës (A - Çështje të përgjithshme; B - Imigracioni, Azili dhe Kufijtë; C - E drejta civile dhe Shtetësia; dhe D - Siguria e Brendshme dhe Drejtësia Penale).<sup>16</sup>

### **Parlamenti Evropian**

Kur është e nevojshme për të arritur objektivat e parashikuara në nenin 67, lidhur me parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit dhe veprimtarive të lidhura me të, Parlamenti Evropian vendos përmes rregulloreve sipas procedurës së zakonshme legjislative, një kuadër për masat administrative lidhur me lëvizjet e kapitalit dhe pagesat, siç janë ngrirja e fondeve, pasurive financiare ose fitimeve ekonomike që u përkasin ose janë në pronësi të personave fizikë ose juridikë, grupimeve ose subjekteve jo shtetërore.<sup>17</sup>

### **Gjykata e drejtësisë**

Për sa i përket bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet kriminale, çdo shtet anëtar mund t'i kërkojë Gjykatës një mendim paraprak mbi interpretimin e vendimeve, interpretimin e Konventave etj. Gjykata gjithashtu ka kompetenca të zgjidhë mosmarrëveshjet në këtë fushë midis shteteve anëtare.<sup>18</sup>

---

<sup>15</sup> Abdulla Azizi, Bashkimi Evropian, Shkup, 2014, f. 3.

<sup>16</sup> Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme në Bashkimin Evropian, Buletin, Ky botim realizohet me mbështetjen financiare të Fondit Think Tank, Program i Rrjetit të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur, Budapest, Hungari, Nr. 1, 2018, f. 8.

<sup>17</sup> Version i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian, Botuar nga Ministria e Integritimit, Tiranë, Shqipëri Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme në Bashkimin Evropian, Buletin, Ky botim realizohet me mbështetjen financiare të Fondit Think Tank, Program i Rrjetit të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur, Budapest, Hungari, Nr. 1, 2018, neni, 75.

<sup>18</sup> Abdulla Azizi, Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 321.

## **Instrumentet për bashkëpunim mes shteteve anëtare në fushën e politikës së brendshme dhe të drejtësisë**

**CIREFI** - Qendra për Informim, Diskutim dhe Shkëmbim mbi Kalimin e Kufijve dhe Emigracionin u krijua me një vendim të Ministrave përgjegjës për imigracionin më 30 nëntor dhe 1 dhjetor 1992. Në vitin 1994, u vendos të zgjeronte aktivitetet e tij për të përfshirë mbledhjen e informacionit mbi: imigracioni legal, emigracioni i paligjshëm dhe qëndrimi i paligjshëm, hyrja e të huajve përmes rrjeteve të lehtësuesve, përdorimi i dokumenteve false ose të falsifikuara, masat e marra nga autoritetet kompetente, në formën e statistikave. CIREFI gjithashtu analizon informacionin e përpiluar, nxjerr përfundime dhe, sipas rastit, jep këshilla dhe inkurajon shkëmbimin e informacionit në lidhje me shoqërimin deri në kufi (vendi i destinacionit, transportuesit, tarifrat, kushtet e transportit, problemet e marrjes së dokumenteve të kthimit). CIREFI përbëhet nga ekspertë nga shtetet anëtare dhe takohet çdo muaj me mbështetje logjistike nga Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit. Në raste urgjente, departamentet qendrore të Shteteve Anëtare në fjalë shkëmbejnë informacion drejtpërdrejt. CIREFI i dorëzon Këshillit raport vjetor për aktivitetet e veta, si dhe raporte tjera sipas kërkesës.<sup>19</sup>

**EUROPOL** me seli në Hagë, Holandë. Misioni i Europolit është të mbështesë Shtetet Anëtare në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit të rëndë ndërkombëtar dhe të organizuar, krimit kibernetik dhe terrorizmit. Europol gjithashtu punon me shumë shtete partnere jashtë BE-së dhe organizata ndërkombëtare.<sup>20</sup>

Zyra e Policisë Evropiane (Europol) është një nga projektet më ambicioze evropiane në fushën e bashkëpunimit për drejtësinë dhe punët e brendshme.<sup>21</sup>

**Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit - OLAF**, në frëngjisht: Office de Lutte Anti-Fraude.<sup>22</sup> Përdorimi jo i duhur i fondeve të siguruar nga buxheti i BE-së ose evazioni i taksave, detyrimeve dhe tatimeve, që financojnë buxhetin e BE-së, dëmton drejtpërdrejt qytetarët evropianë dhe paragjykon të gjithë projektin evropian.<sup>23</sup> Misioni i Zyrës Evropiane kundër mashtrimit është kryerja e hetimeve të pavarura për mashtrimin dhe korrupsionin që përfshin fondet e BE-së, në mënyrë që të sigurohet që të gjitha paratë e taksapaguesve të BE-së të arrijnë në projekte që mund të krijojnë vende pune dhe rritje në Evropë, duke kontribuar në forcimin e besimit të qytetarëve në institucionet e BE-së duke hetuar sjellje të

<sup>19</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM%3A133100>

<sup>20</sup> <https://www.europol.europa.eu/about-europol>

<sup>21</sup> Ivica Josifović, Drejtësia dhe çështjet e brendshme të Bashkimit Evropian, Universitet Goce Delçev Shtip, Shtip, 2020, f. 314.

<sup>22</sup> [https://anti-fraud.ec.europa.eu/about-us/history\\_en](https://anti-fraud.ec.europa.eu/about-us/history_en)

<sup>23</sup> [https://anti-fraud.ec.europa.eu/about-us/what-ww-do\\_en](https://anti-fraud.ec.europa.eu/about-us/what-ww-do_en)

pahijshme serioze nga stafi i BE-së dhe anëtarët e institucioneve të BE-së, zhvillimi i një politike të shëndoshë kundër mashtrimit të BE së.<sup>24</sup>

### **Sistemi i marrjes së gjurmëve të gishtërinjve (EURODAC)**

**EURODAC** është baza e të dhënave e gjurmëve të gishtërinjve të azilit të BE-së. Ai përmban gjurmët e gishtërinjve të të gjithë aplikantëve për azil nga çdo shtet anëtar dhe gjurmët e personave të kapur në një kalim të parregullt kufitar. Roli i tij kryesor është të ndihmojë në përcaktimin e shtetit anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil të bërë në BE dhe në këtë mënyrë zbatimin e “Rregullores së Dublinit”.<sup>25</sup>

### **Sistemi i Informacionit Shengen (SIS)**

Sistemi i Informacionit Shengen (SIS) është sistemi më i madh dhe më i përdorur për shkëmbimin e informacionit për sigurinë dhe menaxhimin e kufijve në Evropë. Sistemi u zhvillua për të kompensuar mungesën e kontrolleve të kufirit të brendshëm midis vendeve të Shengenit. Ai është mjeti më i suksesshëm i bashkëpunimit midis kufirit, imigracionit, policisë, doganave dhe autoriteteve gjyqësore në BE dhe shteteve të lidhura me vendet e Shengenit. Që nga viti 1995, SIS ka ndihmuar Evropën për të garantuar sigurinë në mungesë të kontrolleve të kufirit të brendshëm. Në vitin 2013, u prezantua gjenerata e dytë e SIS (SIS II), me funksione shtesë si mundësia për të shtuar shenjat e gishtërinjve dhe fotot në sinjalizime.<sup>26</sup>

### **Urdhër Arresti Evropian (EAW)**

Urdhër-Arresti Evropian (EAW) është procedurë ligjore që thjeshton procedurën e dorëzimit dhe ekstradimit të personave nga një shtet anëtar i BE-së në një tjetër. Një urdhër i lëshuar nga organet gjyqësore të një shteti anëtar është në fuqi në të gjithë Bashkimin Evropian. Kjo do të thotë që shtetet anëtare nuk kanë të drejtë të refuzojnë të dorëzojnë shtetasin e tyre tek organet e një shteti tjetër anëtar nëse ai ose ajo ka kryer ose dyshohet të ketë kryer një krim në atë shtet anëtar tjetër. Urdhër Arresti Evropian është një mjet me të cilin gjyqësori lufton krimin dhe terrorizmin në Evropë në mënyrë më efektive.<sup>27</sup>

---

<sup>24</sup> Ibid.

<sup>25</sup> <https://www.thalesgroup.com/en/markets/digital-identity-and-security/government/customer-cases/eurodac>

<sup>26</sup> <https://schengenvisum.info/sq/sistemi-i-rinovuar-i-informacionit-Shengen-%C3%ABsht%C3%AB-funksional/>

<sup>27</sup> Jellena Babiq Barnes, Instrumentet e Bashkimit Evropian për luftë kundër krimit të organizuar, Beograd, 2020, f. 48.



## **Instrumentet për realizimin e politikës së Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme**

Instrumentet për realizimin e politikës së Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme të parapara nga Traktati i Amsterdimit janë:

**Qëndrime të përbashkëta:** Këshilli i BE-së mund të marrë ‘pozicione të përbashkëta’ në mënyrë unanime, me të cilat përcaktohet qëndrimi i BE-së mbi një çështje të caktuar, qëndrim ky i cili merret parasysh nga institucionet e shteteve anëtare kur vendoset për çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë dhe punët e brendshme.

**Vendime kornizë:** Këshilli mund të adoptojë gjithashtu vendime në fushën e DPB-së, të cilat nuk mund të kenë efekt direkt, që shoqërohen me masa zbatuese. Këshilli i BE-së ishte në gjendje të miratojë veprime të përbashkëta në vitin 1996, me qëllim krijimin e një drejtorie të specializuar për të luftuar terrorizmin. Këshilli i miraton vendimet në unanimitet, ndërkohë që masat zbatuese, kur është e nevojshme, mund të adoptohen me shumicë të kualifikuar.<sup>28</sup>

**Konventat:** Këshilli i BE-së mund të hartojë konventa të cilat ua rekomandon shteteve anëtare për adoptim. Për dallim nga qëndrimet e përbashkëta dhe vendimet, konventat duhet të ratifikohen nga parlamentet kombëtare të të gjitha shteteve anëtare. Ato janë një instrument jo shumë efektiv, pasi ekziston një numër jo i vogël konventash të nënshkruara, zbatimi i tyre akoma nuk është realizuar plotësisht.

**Rezolutat, rekomandimet, deklaratat dhe konkluzionet:** këto instrumente përdoren shpesh për fleksibilitet, ndryshe nga instrumente të tjerë të përmendur më sipër, ato nuk janë detyruese për shtetet anëtare.<sup>29</sup>

### **Conclusion**

Integration in the field of justice and internal affairs was not included in the Agreement establishing the European Community. But as time went on, it became clear that freedom of movement meant giving someone the same protection and access to justice everywhere in the EU. For this reason, the field of freedom, security and justice gradually developed over the years, first with the Single European Act, the Agreement on European Union, the Maastricht Agreement and the Amsterdam Agreement. European citizens have the right to live in freedom, without fear of being persecuted or subjected to

<sup>28</sup> Abdulla Azizi, *Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat*, Arbëria Design, Tetovë, 2014, f. 321.

<sup>29</sup> Abdulla Azizi, *Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, 326.

violence anywhere in the European Union. But international crime and terrorism are among the issues that most concern Europeans today.

The opening of internal borders between EU member states is a concrete benefit for ordinary people, which enables them to move freely without going through passport controls. But such freedom of internal movement must go hand in hand with strengthening the control of the EU's external borders, in order to succeed against human and drug trafficking, organized crime, illegal immigration and terrorism. EU countries cooperate in the field of police and justice in order to make Europe safer.

**Recensentë:**

**Prof. dr. Enver Abdullahi**

**Prof. dr. Goran Iliq**

**Literatura**

1. Abdulla Azizi, Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat, Arbëria Design, Tetovë, 2010
2. Abdulla Azizi, Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat, Arbëria Design, Tetovë, 2014
3. Blerim Reka, Arta Ibrahim, Studime Evropiane, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë
4. Blerim Reka, Otmar Höll, Ylber Sela, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian, Arbëria Design, Tetovë, 2010
5. Desmond Dinan, Politikat e Bashkimit Evropian, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë
6. Ivica Josifović, Drejtësia dhe çështjet e brendshme të Bashkimit Evropian, Universitet Goce Delçev Shtip, Shtip, 2020
7. Jacques Pertek, E drejta e institucioneve të Bashkimit Evropian, Dispozita ligjore - Edicioni i I –rë qershor 2004, Botimi i 2 –të i rishikuar dhe i zgjeruar : nëntor 2006, Shtypi Universitar i Francës 2004, rruga Reille 6, 75014, Paris
8. Tatjana Petrushevska, Vasko Naumovski, Milena Apostolovska-Stepanoska, Integrimet evropiane, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Fakulteti Juridik “Justiniani i Parë”, Shkup
9. Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian, Botuar nga Ministria e Integritimit, Tiranë, Shqipëri
10. Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme në Bashkimin Evropian, Buletin, Ky botim realizohet me mbështetjen financiare të Fondit Think Tank,

Program i Rrjetit të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur, Budapest, Hungari, Nr. 1, 2018

11. Fjalorth për Integrimin Europian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Europian, Ministria e Integritit, Republika e Shqipërisë, Tiranë, Prill, 2010

12. 15 pyetje për Bashkimin Evropian, Ministria e Integritit Tiranë, 2007

13. Jellena Babiq Barnes, Instrumentet e Bashkimit Evropian për luftë kundër krimit të organizuar, Beograd, 2020

14. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM%3A133100>

15. [https://anti-fraud.ec.europa.eu/about-us/history\\_en](https://anti-fraud.ec.europa.eu/about-us/history_en)

16. [https://anti-fraud.ec.europa.eu/about-us/ëhat-ëe-do\\_en](https://anti-fraud.ec.europa.eu/about-us/ëhat-ëe-do_en)

17. <https://www.thalesgroup.com/en/markets/digital-identity-and-security/government/customer-cases/eurodac>

18. <https://schengenvisum.info/sq/sistemi-i-rinovuar-i-informacionit-Shengen-%C3%ABsht%C3%AB-funksional/>